

HYRJE

Fushat teknologjike janë fusha në të cilat pritet që nxënësit të bëjnë aktivitetet e tyre teknologjike dhe të cilat përbëjnë kornizën e kurrikulit që do të organizohet dhe zhvillohet në shkolla. Renditja e fushave është e rastit dhe nuk paraqet rëndësinë e tyre.

Teknologjia për klasën e dytë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme (trafiku, mjedisi dhe shëndeti) që paraqihen për këtë nivel.

Lënda e punës së dorës ndihmon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve, duke zhvilluar aftësinë e tyre krijuese si dhe ato komunikuese. Lënda ndihmon në formimin dhe në zhvillimin e koncepteve, si në punën e dorës, ashtu edhe në lëndë të tjera mësimore që zhvillohen në shkollë. Puna e dorës shërben edhe si mjet për të ruajtur trashëgiminë tonë kulturore.

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të punës së dorës të nxënësit janë:

- Zhvillimi i një shprehje pozitive të nxënësit ndaj shprehisë në punë dore dhe rëndësisë së saj.
- Familjarizimi me mjedisin dhe motivimi i nxënësve që njohuritë e nxëna t'i shfrytëzojnë në jetë.
- Inkurajimi i nxënësve për të marrë ndonjë nismativë dhe veprim të pavarur, duke patur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grupe, në vartësi nga llojet e ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësi duhet:

Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kuptimin e përparësive dhe kufizimeve që i ofron lënda.
- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, me nisëtiavë, etj.)

Të kuptojë

- Rregullat e trafikut dhe të sigurisë.
- Faktorët që ndikojnë në ndotjen e mjedisit.
- Rregullat e higjienës.
- Vlerat e shëndetit duke përdorur mjetet përkatëse higjienike.

Të zbatojë

- Rregullat e komunikacionit në praktikë.
- Mirëmbajtjen e pastërtisë.
- Ruajtjen e mjedisit.

Të demonstrojë shkathtësi mendore

- Në marrjen e vendimeve të logjikshme (duke i zgjedhur informacionet, njohuritë dhe përfundimet relevante).
- Të ketë besim në vetvete dhe të rrisin besimin në aftësinë e tyre për punë artizanale.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE:

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
1. Trafiku	1.1. Trafiku në vendin tim 1.2. Njohja me rregullat e trafikut 1.3. Zbatimi i rregullave të trafikut	6	33.33 %
2. Mjedisi	2.1. Zhvillimi i raportit të drejtë ndaj mjedisit 2.2. Rregullat e ruajtjes së mjedisit jetësor	6	33.33 %
3. Shëndeti	3.1. Kujdesi ndaj shëndetit	6	33.33%

		shishet, kanaqet etj., si dhe ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve të ndryshme.	Të emërtojë shkaktarët e ndotjes së mjedisit.	
	2.2. Rregullat e ruajtjes së mjedisit jetësor	2.2.1. Rregullat në klasë, në shkollë dhe në mjedisin ku jeton.	Të përshkruajë disa rregulla si duhet të sillemi për mbrojtjen ndaj ndotjes së mjedisit.	
3. Shëndeti	3.1. Kujdesi ndaj shëndetit	3.1.1. Shpjegimi i shërbimeve më të thjeshta që mund të kryejë në praktikën e jetës së përditshme. 3.1.2. Përshkrimi i veprimeve që kryhen për mbajtjen e pastërtisë personale. 3.1.3. Përdorimi i mjeteve dhe mënyrat e thjeshta të mjeteve higjienike (sapuni, furça e dhëmbëve, peshqiri, letra higjienike etj.).	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: Të njohë disa prej rregullave të higjienës, duke i kushtuar kujdes vetes dhe ndonjëherë të tjerëve dhe mjedisit përreth tij. Të identifikojë dhe të dallojë shkaktarët e mundshëm të keqësimit të shëndetit. Të njohë dhe të zbatojë në vazhdimësi e në mënyrë të vetëdijshme rregullat e higjienës, duke i kushtuar kujdes vetes, të tjerëve dhe mjedisit në shkollë dhe në shtëpi.	Gjuhë amtare Arti figurativ

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxënimit bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Vlerësimi i punës individuale
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. Doracakë për mjedisin, trafikun, shëndetin etj.
2. **Erich Neuwirth**: “Spaß beim Forschen und Entdecken 2”, Veritas-Verlag, Linz, Austri, 2001.

Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Trajnime për arsimtarë
2. Kabineti i pajisur me materiale dhe mjete konkretizimi

Kushtet minimale

Trajnime për mësues

UDHËZIME METODOLOGJIKE TË PËRGJITHSHME

1. Qasja problemore në paraqitjen e temës/njesisë
2. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore
3. Inkurajimi i punës individuale dhe shkëmbimit të dijes dhe shkathtësive, puna interaktive

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale

Tirazhi: 200 copë
E përgatiti për shtyp
SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR – Prishtinë
U shtyp në Shtypshkronjën PRINTING PRESS - Prishtinë

Katalogimi në publikim – CIP
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (075.2)

PLANI dhe programi mësimor : Për klasën e parë dhe të dytë të mësimi joformal për shkollën fillore / [Kryeredaktor Isuf Zeneli].- Prishtinë: Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2005 (Prishtinë : "Printing Press").- 88 fq.; 24 cm.

ISBN 9951-450-57-1